VENDIM
Nr. 148, datë 28.5.2026

MBI FILLIMIN E PROCEDURËS LIDHUR ME KËRKESËN E SHOQËRISË "POWER ENERGY" SHPK PËR MODIFIKIMIN E LICENCËS NË VEPRIMTARINË E PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE NGA CENTRALI FOTOVOLTAIK ME KAPACITET TË INSTALUAR 25 mw

Në mbështetje të neneve 16 dhe 43, të ligjit nr. 43/2015, "Për sektorin e energjisë elektrike", të ndryshuar; të neneve 10, pikat 1 dhe 3, dhe 15, të "Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike", të miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 109, datë 29.6.2016, të ndryshuar; si dhe të neneve 15 dhe 19, pika 1, germa "a", të "Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s", miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 28.5.2026, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 1608/1 prot., datë 26.5.2026, të Drejtorisë së Licencimit, Autorizimeve dhe Garancisë së Origjinës "Mbi kërkesën e shoqërisë 'Power Energy' sh.p.k. për modifikimin e licencës në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltaik me kapacitet të instaluar 25 mw",

konstatoi se:

1. Të dhëna për shoqërinë

- Shoqëria "Power Energy" sh.p.k. është licencuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 198, datë 15.8.2025, për prodhimin e energjisë elektrike nga centrali fotovoltaik me kapacitet të instaluar 25 mw, me vendndodhje në zonën kadastrale 3038, fshati Povelçë, Njësia Administrative Dërmenas, Bashkia Fier, qarku Fier, i ndryshuar.

- Me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 1608 prot., datë 15.5.2026, shoqëria ka paraqitur kërkesën për modifikimin e aneksit A të licencës së saj, duke shtuar në të dhe sistemet e akumulimit/depozitimit të energjisë, si vepra ndihmëse, pa ndryshuar kapacitetin total të centralit, prej 25 mw.

- Nëpërmjet vendimit të Këshillit të Ministrave (VKM) nr. 310, datë 4.6.2025 dhe kontratës nr. 5129 rep., nr. 2337 kol., datë 13.6.2025, të nënshkruar me Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE), shoqëria ka fituar të drejtën "Për ndërtimin, shfrytëzimin dhe administrimin e centralit gjenerues të energjisë elektrike fotovoltaike, me kapacitet prodhues 25 mw, dhe veprave ndihmëse, i cili nuk është objekt koncesionit, në zonën kadastrale 3038, fshati Povelçë, Njësia Administrative Dërmenas, Bashkia Fier, qarku Fier, nga shoqëria 'Power Energy' sh.p.k.".

- Rezulton se shoqëria ka kryer pagesën e aplikimit sipas përcaktimeve të aneksit A të rregullores e po ashtu ka shlyer dhe pagesat e rregullimit.

2. Përputhshmëria e aplikimit me rregulloren

- Në përputhje me nenin 15, pika 4 e rregullores, aplikuesi ka dorëzuar dokumentacionin e kërkuar për modifikimin e licencës sipas germave "a", "c", "d", "e", "f" dhe "g".

- Në referencë të përcaktimeve të nenit 15, pika 4, germa "b" të rregullores, shoqëria duhet të bëjë saktësimin përkatës të veprave ndihmëse dhe kapacitetit të secilës.

- Po ashtu, në kuadër të informacionit shtesë, vlerësohet t'i kërkohet shoqërisë të depozitojë një informacion mbi mënyrën se si parashikon financimin e investimit për vendosjen e veprave ndihmëse/njësive të depozitimit të energjisë elektrike.

- Në lidhje me fillimin e procedurës për modifikimin e licencës së shoqërisë sipas kërkesës së saj, vlerësohet që të njoftohet dhe MIE, Agjencia Kombëtare e Mjedisit (AKM) dhe shoqëria "Operatori Sistemit Transmetimit" (OST) sh.a.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të fillojë procedurën për modifikimin e licencës së shoqërisë "Power Energy" sh.p.k. në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike, dhënë me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 198, datë 15.8.2025, për prodhimin e energjisë elektrike nga centrali fotovoltaik me kapacitet të instaluar 25 mw, duke shtuar veprat ndihmëse/njësitë e depozitimit të energjisë elektrike në aneksin A të licencës, pa ndryshuar kapacitetin total të instaluar të centralit.

2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Garancisë së Origjinës të njoftojë shoqërinë "Power Energy" sh.p.k., Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë, Agjencinë Kombëtare e Mjedisit dhe shoqërinë "Operatori i Sistemit të Transmetimit" sh.a., për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t'i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes dijeni të vendimit, rishikimin e vendimit të Bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti